



KËSHILLI DREJTUES

V E N D I M


Nr.10, datë 28.03.2019

**“Mbi miratimin e raportit të PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k.
për auditimin e brendshëm të Sektorit të Teknologjisë së Informacionit
për vitin 2018”**

Në mbështetje të nenit 52, pika 1, shkronja “j”, të nenit 63, pika 2 të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, të nenit 18, pika 1 dhe pika 4 të “Statutit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues të Agjencisë nr. 24, datë 31.10.2018, si dhe të nenit 8, pika 3, shkronja “j” të vendimit të Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014 “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, me propozim të Audituesit të Brendshëm, Këshilli Drejtues i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave

V E N D O S I:

1. Miratimin e raportit të PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k. për auditimin e brendshëm të Sektorit të Teknologjisë së Informacionit për vitin 2018, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Sektori i Teknologjisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.



KËSHILLI DREJTUES

3. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Martin Blushi

Sekretar

Donald Duraj

Kryetar